


# “BASHKI VIRTUALE”

## RAPORT MONITORIMI I NIVELIT DHE BILANCIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE, PJESËMARRJES QYTETARE DHE LLOGARIDHËNIES

### TIRANË, KAMËZ, KAVAJË, VORË DHE RROGOZHINË



Tiranë, dhjetor 2018

---

**Ky raport u realizua me mbështetjen e LëvizAlbania në kuadër të projektit  
“BASHKITË E QARKUT TIRANË: TRANSPARENCA, QEVERISJA QYTETARE DHE LLOGARIDHËNIA”.**  
**Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve të ISP dhe nuk përkojnë  
domosdoshmërisht me qëndrimet LëvizAlbania.**

## **EKIPI REALIZUES I RAPORTIT MONITORUES**

### **Drejtues i projektit**

Afrim Krasniqi

### **Ekipi realizues**

Rudina Niklekaj

Silvana Jaupaj

Laurent Ymet

### **Ekipi monitorues**

Lisian Roseni

Brunilda Duriçi

Elsa Kepi

Alban Hoxha

Arben Meta

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2018

*INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE*

*Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)*

*Email: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al) dhe [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com)*

*Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies*

*Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë*

---

## 1. HYRJE

---

Bazuar në ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin publik” dhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, secili qytetar në territorin e njësisë ka të drejtë të paraqesë mendime, kërkesa, sugjerime, ndaj autoriteteve publike, gjatë procesit të hartimit të akteve normative apo gjatë ushtrimit të funksioneve të autoritetit publik. Mbi këtë parim, njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre (neni 15/139) dhe se do akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Në funksion të konsultimit publik, (neni 16/139) *“organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes”*. Ligji detyron Këshillin Bashkiak të zhvillojë mbledhje të hapura për publikun, të bëjë publike rendin e ditës me akses informimi nga qytetarët, si dhe të mundësojë konsultime midis bashkisë e këshillit, midis bashkisë dhe komunitetit, midis këshillit dhe grupeve të interesit. Procesi i këshillit me publikun (neni 18/139) bëhet në çdo rast *“sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore”*. Ligji detyron gjithashtu që aktet e këshillit të publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore, etj.

Këto detyrime ligjore dhe standarde të reja të legjislacionit mbi konsultimin publik dhe qeverisjen vendore, janë objekt monitorimi i Institutit të Studimeve Politike për rastet e pesë bashkive të qarkut Tiranë. Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Lëviz Albania (LA) po kryen hulumtime në nivele të ndryshme të aktivitetit të këshillave bashkiakë dhe të bashkive të qarkut Tiranë (Tiranë, Kavajë, Kamëz, Vorë e Rrogozhinë). Projekti “Bashkitë e qarkut Tiranë: transparenca, qeverisja qytetare dhe llogaridhënia” kanë në fokus edhe matjen e treguesve të pjesëmarrjes qytetare, llogaridhënies, transparencës dhe të konsultimit publik në pesë bashkitë.

ISP ka publikuar më parë një raport vlerësimi për nivelin e angazhimit publik të këshilltarëve bashkiakë në pesë bashkitë, si dhe problematika që lidhen me këtë angazhim dhe me rolin e këshillave bashkiakë. Raporti iu përcoll të gjithë këshilltarëve dhe në tërësi pati reagime pozitive. Gjatë muajve tetor – nëntor ISP organizoi tryeza pune në secilën bashki, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga bashkia, këshilli bashkiak, administratorët, institucionet e varësisë së bashkisë, media lokale, komuniteti lokal dhe grupet e tjera të interesit. Në këto takime u evidentuan probleme të shumta specifike lokale, por në tërësi u konstatua edhe distanca ende e madhe midis qytetarëve e vendimmarrësve lokalë në emër të tyre.

Raportet e ISP nuk synojnë krijimin e një imazhi kritik për strukturat lokale qeverisëse, por matjen e treguesve të përfaqësimit dhe të transparencës, analizimin e problematikave dhe sugjerimin e rrugëzgjdhjeve sa më optimale për të ardhmen. Në këtë synim ISP e sheh veten partner të vetë bashkive dhe vetë bashkitë si institucione shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme për jetën dhe aktivitetin qytetar në territorin e tyre.

---

## 1. GJETJET DHE REKOMANDIMET KRYESORE

---

- Bashkitë e qarkut Tiranë kanë nivel të pakënaqshëm në bilancin e tyre në lidhje me zbatimin konkret të detyrimeve dhe përgjegjësi që burojnë nga ligjet 146/2014 dhe 139/2015 lidhur me standardet e konsultimeve publike, pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës. Të gjitha bashkitë janë deficite në zbatimin e ligjit dhe një tregues tjetër simbolik i diferencës midis parimeve të larta ligjore dhe nivelit kritik të zbatimit të tyre në Shqipëri.
- Pesë Bashkitë nuk kanë faqe interneti me elementët e nevojshëm që kërkohen nga ligjislacioni, me mundësi ndërveprimi dhe me informacion në kohë e me cilësi në funksion të qytetarëve, të konsultimit publik, transparencës dhe vendimmarrjes përmes qytetarëve.
- Bashkitë e qarkut Tiranë i kanë dhënë prioritet thelbësor komunikimit me qytetarët në rrugë virtual, përmes faqeve të tyre në rrjetet sociale (sidomos në facebook), si formë më atraktive dhe më e shpejtë, por edhe më e njëanshme komunikimi. Adresimi përmes internetit është më i lehtë, por nuk shkon tek të gjitha grupet e qytetarëve në bashki, dhe se nuk mund të zëvendësojë format tradicionale të komunikimit dhe të informimit, të përcaktuara edhe nga legjislacioni dhe vetë rregulloret e bashkive.
- Bashkia Tiranë ka një bilanc pozitiv në numrin e dëgjësave publike, por natyra e këtyre dëgjësave është më shumë në funksion të agjendës politike të partisë që drejton bashkinë sesa në funksion të standardeve ligjore për qeverisjen vendore. Folës kryesorë janë figura partiake, slogani është i njëjtë me partinë dhe pjesëmarrësit janë kryesisht rrjete të organizimit brenda-partiak.
- Bashkia Vorë është bashkia e vetme, ku në aktivitetet e bashkisë nuk ka deklarime dhe as pjesëmarrje me natyrë politike, ku dominon lajmi “i bashkisë për bashkinë” mbi çdo lajm politik dhe ku raporti midis bashkisë e qytetarëve ka nivel më të lartë besimi.
- Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë botojnë gazeta lokale periodike, të cilat tentojnë të zëvendësojnë mungesën e medieve të tjera lokale, por që në tërësi janë në funksion të informimit të njëanshëm nga bashkia për qytetarët dhe jo të qytetarëve për bashkinë.
- Komunikimi virtual në rrjetet sociale i bashkive shoqërohet me tendencën e kontrollit të komenteve dhe censurimit të mendimit kritik nga qytetarët, nga përpjekja për të nxjerrë në pah cilësi pozitive individuale të kryetarit të bashkisë dhe se janë të pakta rastet e ndërveprimit, - komenteve qytetare dhe përgjigjeve sqaruese nga ana e bashkisë.
- Bashkitë duhet ti japin prioritet promovimit të kapaciteteve dhe potencialeve të tyre humane, historike, kulturore, shoqërore, etj, duke zëvendësuar praktikën e investimit

---

personal te imazhi i kryetarëve të zgjedhur periodikë, tek investimi tek institucioni i bashkisë dhe rrjeti i komuniteteve lokale në bashki.

- Bilanci i monitorimit nxjerr në pah nevojën emergjente që bashkitë: kryetarët, njësitë administrative dhe këshillat bashkiakë të reflektojnë për të vendosur në axhendë prioritare zbatimin rigoroz dhe cilësor të ligjit mbi konsultimin publik dhe mbi vetëqeverisjen vendore në kapitujt për transparencën, pjesëmarrjen, konsultimin dhe llogaridhënien.
- Këshillat Bashkiakë duhet të rrisin ndjeshëm performancën e tyre, për të luajtur rolin kushtetues e ligjor të “parlamentit lokal”, kontrollues të bashkisë dhe përfaqësues të qytetarëve. Raportet shpeshherë kritike midis Këshillave dhe Kryetarit të Bashkisë nuk mund të jenë alibi për të mos përmbushur detyrimin ligjor për konsultime dhe pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje nga vetë këshillat dhe këshilltarët.
- Bashkitë duhet të krijojnë mekanizma efikasë informimi dhe ndërveprimi me qytetarët, brenda kuadrit ligjor dhe brenda praktikave e standardeve më të mira qeverisëse, për të përmbushur detyrimin ligjor por edhe për të qenë shembull për bashkitë e tjera në nivel kombëtar.
- Bashkitë dhe këshillat bashkiakë duhet të marrin një herë në vit në analizë gjendjen dhe problematikat e bashkive në raport me ligjin 146/2014 dhe 139/2015 për të bërë bilancin dhe për të krijuar mekanizma efikasë që mundësojnë zbatimin integral të ligjit dhe standardeve të tij.
- Bashkitë dhe këshillat bashkiakë duhet të mundësojnë buxhete specifike lidhur me konsultimet publike dhe llogaridhënien, të kenë kalendar publik mbi masat dhe aktivitetet në këtë drejtim, të kenë një sistem të dyanshëm informimi me grupet qytetare dhe organizatat e shoqërisë civile e medien lokale.
- Bashkitë duhet të krijojnë produkte të matshme që provojnë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies (vlerësime periodike për stafet drejtuese në bashki dhe në njësi, informacion publik për përdorimin e buxhetit dhe projektet afatgjata e afatshkurtra, nivelin e marrjes së opinionëve nga grupet e interesit dhe reflektimin e tyre, nivelin e perceptimit qytetar ndaj problematikave më të rëndësishme lokale, etj).
- Bashkitë dhe organi tjetër përfaqësues, - deputetët e Kuvendit, duhet të kenë një sistem komunikimi të përhershëm dhe konstruktiv, pavarësisht përkatësive të partive politike, për të trajtuar në rrugë ligjore dhe me efikasitet problematikat e konstatuara në periudhën e implementimit të reformës së re territoriale, sidomos lidhur me kompetencat e pushtetit vendor, buxhetin, përfaqësimin më të mirë të qytetarëve dhe mbrojtjen e interesave të vetë banorëve të njësisive bashkiake.

---

## 2. METODOLOGJIA

---

Stafi i ISP ka shfrytëzuar disa mekanizma dhe forma të mbledhjes së informacionit që lidhen me konsultimet publike dhe transparencën në bashkitë e qarkut Tiranë.

### Burimet institucionale

- Legjislacioni në fuqi ka të përcaktuar mekanizmat e programit të transparencës, të konsultimit publik dhe të llogaridhënies. ISP ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme faqet zyrtare të internetit të secilës bashki, arkivin e informacioneve gjatë vitit të fundit, regjistrimin e kërkesave për informacion, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me mbledhjet e Këshillit Bashkiak, me procesverbale dhe aktivitete publike lidhur me informimin dhe transparencën.
- Stafi i ISP ka monitoruar ekzistencën e bazës ligjore plotësuese, siç janë rregulloret dhe aktet e tjera në funksion të zbatimit të ligjit, nëse ato janë miratuar dhe nëse ekzistojnë, nëse janë të publikuara online dhe nëse qytetarët kanë akses në përmbajtjen e tyre.

### Burimet direkt dhe ato testuese

- Stafi i ISP ka kontaktuar me drejtues të secilës prej bashkive, në mënyrë që të marrë prej tyre informacion më të zgjeruar për praktikatat e punës në konsultimet publike dhe në aplikimin e programit të transparencës. Pjesë e komunikimit kanë qenë edhe këshilltarë nga secila bashki, në mënyrë që të dhënat zyrtare të bashkive të testohen edhe nga perceptimi i organit legjislativ në bashki.
- ISP ka adresuar kërkesa të vazhdueshme për informacion në bashkitë e qarkut Tiranë, kryesisht kërkesa që lidhen me transparencën, me praktikatat e konsultimeve publike, me ekzistencën e procesverbaleve dhe materialeve të provës mbi konsultimet, mbi buxhetet lokale mbi konsultimin publik dhe aspekte të tjera të përgjegjësive të bashkive, mbi ndryshimet në organikë, në përbërjen e këshillit bashkiak, pjesëmarrjen në mbledhje dhe takime, etj. Përmes këtyre komunikimeve ISP ka pasur mundësinë të testojë sistemin e informacionit edhe në rrugë të drejtpërdrejtë.
- Stafi i ISP ka aplikuar si individë në programe të ndryshme të ofruara nga bashkitë, si psh, në aplikacionin Tirana ime, etj, si dhe ka adresuar kërkesa/ankesa në zyra që mbulojnë fusha të ndryshme shërbimesh në bashki

### Monitorimi i aktivitetit publik të bashkive

- Në monitorimin e aktivitetit publik, stafi i ISP është përqendruar në monitorimin e faqeve online të bashkive, të programeve të ndryshme që ato ofrojnë mbi informacionin publik, si dhe kryesisht në monitorimin e raportimeve të bashkive në mediet sociale. Fokusimi në mediet sociale, facebook dhe twitter lidhet me faktin se vetë bashkitë e kanë përqendruar aktivitetin e tyre në këto rrjete, janë shumë të familjarizuara me to dhe i konsiderojnë instrumente të shpejta dhe efikase informimi dhe transparence. Në profilet në FB dhe twitter përfshihen profilet e bashkive dhe të drejtuesve të bashkive, edhe për shkak se në shumicën e rasteve njoftimet janë të njëjta.
- Të dhënat e mbledhura i përkasin periudhës deri më 1 dhjetor 2018.

---

### 3. MEKANZIMAT E KONSULTIMIT, VENDIMMARRJES DHE TË LLOGARIDHËNIES

---

Legjislacioni në fuqi (ligjet 146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin publik” dhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) kanë krijuar një bazë të fuqishme ligjore për të jetësuar standarde të reja të përfaqësimit dhe llogaridhënies në nivelin vendor. Ato përbëjnë risi në legjislacion dhe duhet të jenë edhe risi në praktikën dhe modelin qeverisës vendor e qendror.

Detyrimet e institucioneve vendore për të pasur standarde të larta të transparencës, llogaridhënies dhe konsultimit publik, nuk janë masa penalizuese por mbështetëse për të rritur nivelin e mirëqeverisjes dhe për të krijuar një sistem sa më funksional në shërbim të qytetarëve. Vetë bashkitë kanë përgjegjësinë të krijojnë akte nënligjore në zbatim të detyrave të ligjit, - rregullore mbi mënyrën e realizimit të llogaridhënies dhe të transparencës, të konsultimeve dhe dëgjësive publike, etj.

Nga të dhënat e ISP jo të gjitha bashkitë i kanë miratuar ato. Bashkia Tiranë ka rregullore të verifikueshme. Bashkia Vorë e Kamëz, Kavajë e Rrogozhinë deklaruan se kanë miratuar akte të ndryshme të konsultimit, por ato nuk gjenden online dhe as nuk u identifikuan as pas kërkesës për informacion dhe verifikimet e ndryshme nga stafi i ISP.

Këshilli Bashkiak ka një rol specifik të jetësimit të transparencës, llogaridhënies, pjesëmarrjes dhe konsultimit publik. Ai përbën një organ të zgjedhur, legjitim, me shtrirje gjithë-partiake, me burime të shumta informimi në dispozicion, me kompetenca të gjera në kontrollin e aktivitetit të bashkisë dhe në vendimmarrjen bashkiake, si dhe me mekanizma të shumta në dispozicion për të krijuar një sistem të vazhdueshëm të llogaridhënies dhe të konsultimit publik. Treguesit e deritanishëm të monitorimit nuk ofrojnë të dhëna optimiste mbi mënyrën sesi këshillat bashkiakë në pesë bashkitë e qarkut Tiranë e kanë kryer e po e kryejnë funksionin e tyre, megjithatë ky është mandati i parë në kuadër të reformës së re territoriale dhe disa nga problematikat kanë qenë të paparashikuara.

Monitoruesit e ISP dhe stafi i angazhuar në projektin mbledhës të dhëna të shumta nga bashkitë dhe në konkludim të tyre, mundësoi këtë raport monitorues mbi bilancin e deritanishëm të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe të standardeve të reja të legjislacionit mbi konsultimin publik, llogaridhënies dhe mirëqeverisjes vendore.

---

#### 3.1. TIPARET KRYESORE TË KOMUNIKIMIT TË BASHKIVE ME QYTETARËT

---

Në analizën e mënyrës sesi bashkitë e reflektojnë në publik aktivitetin e tyre dhe sesi kanë krijuar raporte komunikimi me qytetarët – votues, si dhe në mënyrën sesi janë përmbushur ose jo kërkesat ligjore që lidhen me konsultimet publike, pjesëmarrjen qytetare, dëgjesa dhe transparencën publike, në tërësi në pesë bashkitë e qarkut Tiranë reflektohen disa tipare kryesore.

---

### 3.1.1. CENTRALIZIMI I INFORMACIONIT, TIPAR I QEVERISJES VENDORE?

---

ISP ka pasur dhe ka praktika të shumta komunikimi shkresor ose përmes mjeteve të tjera të komunikimit / korrespondencës me bashkitë e qarkut Tiranë. Në tërësi, praktika mbetet e njëjtë: kërkesat për informacion ose nuk marrin përgjigje në kohë, ose marrin përgjigje formale shumë larg subjektit të informacionit të kërkuar.

Në bashki qendrore si Tirana, në 40% të rasteve mungojnë përgjigjet, dhe ato që vijnë kanë vonesa në kohë dhe janë kryesisht përgjigje të përgjithshme pa informacion të thelluar e direkt mbi objektin e kërkuar. Në bashki si Kamza, përgjigjet janë gjithashtu formale dhe larg përmbajtjes së kërkuar në kërkesën për të drejtën e informimit; në bashki si Vora dhe Kavaja për të marrë përgjigje në shumicën e rasteve kërkohet komunikim me nivelet drejtuese të bashkisë dhe jo thjesht me zyrat përgjegjëse për informim. Në tërësi në secilën bashki, qoftë për kërkesat ndaj bashkisë, ndaj këshillit apo ndaj institucioneve të varësisë, procedura burokratike e miratimit të informacionit për përgjigje është e gjatë, shumë më e gjatë dhe më e komplikuar sesa praktika ligjore, dhe shpesh edhe i ndryshëm nga thelbi i informacionit të detajuar që kërkohet.

Pra, në tërësi bashkitë e respektojnë vetëm formalisht ligjin mbi të drejtën e informimit dhe se mungon një praktikë unike dhe një sistem funksional i trajtimit dhe ndjekjes së kërkesave për informacion. Kur përvoja të tilla krijohen në komunikim me organizata si ISP, zyrtarisht monitoruese të bashkive dhe me pritshmëri për publikime të raporteve monitoruese, nënkuptohet lehtësisht vështirësia e shumëfishtë që kanë organizata e individë të tjerë që nuk kanë këtë status institucional në raport me bashkitë.

### 3.1.2. NGA KONTAKTI ME QYTETARIN REAL TEK KONTAKTI ME QYTETARIN VIRTUAL

---

Një prej tipareve kryesore të komunikimit në pesë bashkitë e qarkut Tiranë është tendenca për t'iu larguar komunikimit direkt me qytetarët dhe kalimi në një komunikim virtual, ku qytetarët marrin atë informacion që bashkia kërkon tua përcjellë dhe ku mundësitë e ndërveprimit janë minimale.

Në secilën bashki, sipas të dhënave të monitorimit të vazhdueshëm nga ISP, ka të dhëna të shumta që tregojnë se stafet bashkiake i japin shumë rëndësi komunikimit virtual, ndërkohë që ka tregues minimalë të aplikimit të standardeve ligjore për dëgjuesat, konsultimet dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen lokale. Komunikimi virtual është vetëm një prej mekanizmave të shumtë të komunikimit, ndërkohë që legjislacioni i jep prioritet komunikimit dhe pjesëmarrjes direkt qytetare. ISP ka kryer edhe një anketim të thelluar me qytetarët në lidhje me këto problematika, dhe të dhënat që do të bëhen publike së shpejti, provojnë konstatimin e mësipërm.

### 3.1.3. REAGIM I PJESSHËM NDAJ PROBLEMATIKAVE QYTETARE

---

Monitorimi i faqeve zyrtare të bashkive nuk lejon të krijohet ideja e saktë sesi bashkitë iu përgjigjen kërkesave të qytetarëve, në funksion të detyrimit ligjor për të drejtën e informimit dhe për vetëqeverisjen lokale. Regjistri i kërkesave për të drejtën e informimit nuk është i axhornuar dhe se vetë ISP në adresimin e më shumë se 10 kërkesave në kohë të ndryshme për secilën bashki, testoi



edhe sistemin e reagimit të tyre. Pikërisht, shfrytëzimi i mekanizmave të tjerë për informim, siç janë kërkesat për informim adresuar në emër të stafit monitorues të ISP apo monitorimi i lajmërimeve dhe komunikimeve që ka bashkia në rrjetet sociale, lejon të krijohet përshtypje më e qartë rreth nivelit të transparencës publike të bashkive.

Bashkia Tiranë është e vetmja që ka një program të dedikuar komunikimi, aplikacioni Tirana ime, i cili publikon rregullisht edhe numrin e ankesave që vijnë nga qytetarët. Publikimi shoqërohet me ankesën, përgjigjen, foto apo të dhëna të tjera. Pavarësisht risisë pozitive, sidomos në aspektet e informimit mbi trafikun dhe të dhëna të tjera publike, aplikacioni nuk ka mekanizëm testues të transparencës dhe të mirë-funksionimit të tij. Stafi i ISP adresoi në javën e fundit 4 ankesa të ndryshme nga adresat personale dhe vetëm 1 prej tyre u pasqyrua në sistem.

Në rrethana të tilla dhe për shkak se vetë bashkitë shumicën e aktivitetit të tyre publik e adresojnë në mediet sociale, stafi i ISP kreu monitorimin e raportimeve në mediet sociale në adresat e bashkive dhe të kryetarëve të bashkive. Nga të dhënat rezultoi se midis pesë bashkive të qarkut Tiranë ka diferenca në mënyrën sesi sillen me kërkesat e qytetarëve të ardhura përmes rrjeteve sociale. Për shembull, dy bashkitë më të mëdha, Tirana e Kamza, nuk kanë një sistem përgjigjeje publike në faqen e bashkive në FB lidhur me komentet kritike ose sugjerimet/kërkesat që vijnë nga qytetarët e tyre. Ka bashki të tjera të cilat praktikojnë një komunikim më aktiv, duke dhënë përgjigje dhe informacione të ndryshme për problematikat. Konkretisht, shumica e kritikave të banorëve të bashkisë Vorë lidhen me vështirësitë dhe gjendjen kaotike të shërbimit të autobusëve, por në një përgjigje të bashkisë në faqen e saj të FB theksohet se për këtë problem përgjegjësi është bashkia Tiranë, e cila ka autoritetin ligjor të miratimit.

Në një rast tjetër ilustrues, në bashkinë Kavajë, qytetarët adresojnë problematika specifike lokale në FB, siç është kërkesa për investim në rrugën Synej-Bago-Bardhore dhe bashkia përgjigjet se *“e kemi ne vemendjen tone sistemimin e kesaj rruge por ka nje specifike qe nje pjese e dheut eshte e rreshkitshme dhe eshte e veshtire per momentin qe te nderhyhet, gjithesesi do bejme maksimumin qe ta sistemojme kete aks”*. E njëjta metode komunikimi është kontaktuar në të paktën 50 raste gjatë komunikimeve të 3 muajve të fundit në faqen e bashkisë në FB.

#### **3.1.4. TRENDI I BASHKIVE: CENSURIM TË KRITIKAVE DHE LAVDE NDAJ KRYETARËVE**

Analiza e cilësisë së raportimeve në medien online dhe në komunikimin midis bashkisë e qytetarëve, (përmes administratorit të faqes së bashkisë në facebook / twitter) tregon se në tërësi kemi të bëjmë me një sistem të njëanshëm komunikimi: monitorimi tregoi se adresimi publik i bashkive ka trendin të jetë i kontrolluar nga administratorët e faqeve në rrjetet sociale, për sa kohë që në bashki si p.sh, Tirana apo Kamzë rrallë gjendet ndonjë kritikë ndërkohë që gjenden komente të shumta lavdëruese për kryetarin dhe stafin.

Një analizë më e detajuar e komenteve mbështetëse tregon se në përgjithësi janë të njëjtët persona që lavdërojnë në çdo koment, duke krijuar përshtypjen se kemi të bëjmë me stafe të gatshme që kontrollojnë dhe administrojnë faqet e bashkive, në funksion të promovimit të drejtuesve të tyre dhe jo komunikimit korrekt e transparent me qytetarët. Në tërësi konstatohet trendi sipas të cilit,

---

kritikat fshihen ose censurohen dhe dominuese publikimi i atyre komenteve që lavdërojnë kryetarin si individ me një gjuhë militante dhe shpesh pa lidhje me postimet.

Në pesë bashkitë evidentohen raste kur faqja e bashkisë në rrjetet sociale është burim kryesor informimi (p.sh, bashkia Vorë), por edhe raste kur në vend të faqes së bashkisë prioritet komunikimi i është dhënë adresës së personalizuar të stafit drejtues të bashkisë (Rrogozhinë), kur “rivalizojnë” postimet e kryetarit me ato të bashkisë (Kamëz, Kavajë dhe sidomos në Tiranë), siç ka raste kur postimet në rrjetet sociale nuk kanë natyrë partiake (Vorë) dhe kur kanë thellësisht natyrë partiake (Tiranë e Kamëz), apo kur aktivitetet e partisë bëhen share nga stafet bashkiake (Rrogozhinë, Kamëz) apo kur slogani i partisë bëhet edhe slogan pune për vetë bashkinë (Tiranë e Kamëz).

---

## 4. LLOGARIADHËNIA E MUNGUAR DHE TIPARET E BASHKIVE, QARKU TIRANË

---

Ekipi monitorues i ISP ka bërë analizën dhe vlerësimin e bilancit kryesor për secilën bashki në treguesit e konsultimeve, llogaridhënies dhe vendimmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Të dhënat i janë përmbajtur të njëjtave kritere: sa funksionale janë faqet e internetit, sa informacion mund të gjejnë qytetarët aty në aplikimin e të drejtës së tyre ligjore, cilët janë mjetet që bashkitë përdorin për komunikimin publik me qytetarët, sa efektive janë raportimet e bashkive në mediat sociale në funksion të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, sa është respektuar detyrimi ligjor për të pasur një sistem publik dhe efikas transparence, konsultimi dhe llogaridhënie, etj.

Të dhënat dhe konstatimet për secilën nga bashkitë janë të renditura në vijim të këtij materiali.

### 4.1. BASHKIA TIRANË: KONSULTIMI PUBLIK APO AKTIVITET PARTIAKE?

---

Analiza e mënyrës sesi zhvillohen konsultimet publike në bashkinë Tiranë është fryt i një numri të madh aspektesh, përfshirë mënyrën sesi planifikohen konsultimet, sesi zhvillohen ato, sesi programohet debati, sesi lajmërohet publiku, sesi sigurohet pjesëmarrja, sesi publikohen të dhënat në faqen zyrtare dhe sesi ruhet dhe përcillet dokumentacioni dhe rezultatet e konsultimit. Bashkia Tiranë është bashkia me aktivitetin më të dendur në bashkitë e qarkut Tiranë, si dhe bashkia me faqen e internetit më aktive në një numër treguesish. Megjithatë, referuar standardeve dhe kërkesave specifike të ligjit, edhe bashkia Tiranë vijon të jetë larg standardeve të kërkuara.

Në media publikohen rregullisht njoftime shtypi mbi forma të ndryshme konsultimi, si takime të kryetarit, inaugurime, fjalime, etj, por që më shumë sesa konsultime janë aktivitete rutinore të praktikës së punës së çdo bashkie. Por informacionin e memorizuar bashkitë e kanë të ruajtur në faqet e tyre zyrtare të bashkive, - një detyrim ligjor dhe standard informimi. Analiza e të dhënave në faqen zyrtare të bashkisë Tiranë tregon se njoftimet e fundit lidhur me konsultimin publik i përkasin vitit 2016. Konkretisht kalendari i fundit i njoftimit për konsultim i përket periudhës korrik 2016 dhe ka të bëjë me debatin mbi planifikimin e Strategjisë së Zhvillimit të Territorit. (Për më shumë shiko [http://www.tirana.al/ep-content/uploads/2016/07/kalendari\\_public.jpg](http://www.tirana.al/ep-content/uploads/2016/07/kalendari_public.jpg)). Po ashtu njoftimi më i fundit i bashkisë lidhur me kalendarin e dëgjësive mbi buxhetin i përket gjithashtu vitit 2016 (Për më shumë shiko <http://www.tirana.al/wp-content/uploads/2016/11/Image161116143018.pdf>).

Të vitit 2016 janë edhe procesverbalet e fundit mbi konsultimet publike, kryesisht në forma të ndryshme, ku shpeshherë me konsultim publik kuptohet zhvillimi i sondazheve nga vetë bashkia mbi problematika të ndryshme që lidhen me punën e bashkisë dhe me efikasitetin e stafëve drejtuese. (Për më shumë shiko <http://www.tirana.al/programi-transparences/konsultimi-public/>).

Edhe për mënyrën e realizimit të dëgjësive dhe konsultimeve publike Bashkia Tiranë ka të publikuar vetëm treguesit e vitit 2016, por ka publikuar edhe një rregullore tip, sipas të cilës theksohet se “për njoftimin dhe marrjen e komenteve dhe rekomandimeve, Bashkia e Tiranës ka përdorur një sërë mekanizmesh si a) posta elektronike; b) lajmërimi publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik

*iniciues; c) lajmërimet në mediet audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; ç) botimet në gazeta lokale ose në gazetatat në nivel kombëtar". Nuk ka të dhëna sesi është realizuar marrja e këtyre komenteve dhe sesa funksionale ka qenë metodika e përcaktuar nga Bashkia, gjithsesi, në çdo rast në faqen zyrtare të internetit referimet i adresohen vitit 2016.*

Gjatë këtij viti vetëm për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të dhjetorit 2016 bashkia (Bashkia dhe Këshilli Bashkiak) lajmëroi se ka zhvilluar 24 dëgjesa në njësitë administrative, 3 dëgjesa ligjore, mbi 100 dëgjesa e takime me grupe interesi si Shoqata e Arkitektëve, grupe mjedisore apo Shoqatat e Ndërtuesve etj si dhe me qytetarë, etj.

Për periudhën 2017 dhe 2018 bashkia Tiranë nuk ka asnjë njoftim në faqen e vet të internetit mbi konsultimin publik, dëgjesat me grupe komunitare e të interesit, për aktivitete në funksion të transparencës dhe as për konsultime që lidhen me buxhetin dhe vendimmarrje të tjera të rëndësishme.

Për shkak të rolit gjithnjë e më të madh që kanë marrë mediet sociale, stafi i ISP analizoi edhe njoftimet e bëra nga bashkia Tiranë në rrjetet sociale, kryesisht në facebook dhe twitter, në adresat e bashkisë, të kryetarit të bashkisë dhe stafit drejtues të saj. Të dhënat vlejné për të kuptuar mekanizmin e konsultimit publik që aplikohet nga bashkia, një informacion i cili nuk gjendet në publikimet zyrtare të bashkisë në faqen e internetit.

Nga të dhënat e periudhës shtator-nëntor 2018 rezulton se bashkia Tiranë ka zhvilluar një numër të madh dëgjesash publike, kryesisht në funksion të bilancit të punës së deritanishme dhe hartimit të buxhetit bashkiak për vitin 2019. E vlerësuar në këtë mënyrë, rezulton se bashkia ka qenë shumë më aktive sesa bashkitë e tjera të qarkut Tiranë dhe se numri i konsultimeve publike ka qenë më i madh se pothuajse shumica e bashkive të tjera në vend.

Megjithatë, një analizë e detajuar e zhvillimit të këtyre konsultimeve dhe dëgjesave publike nxori në pah konceptin e brishtë të "konsultimit publik" dhe rolin dominues që kanë partitë politike dhe agjendat politike në aktivitetet e bashkive, përfshirë edhe bashkia Tiranë. Kështu, nga më shumë se 20 dëgjesa të zhvilluara u konstatua se në asnjë prej tyre nuk ka pasur realisht konsultim publik bashki – qytetarë në modelin ligjor dhe klasik të konsultimit, por në çdo rast ka pasur aktivitet bashkiak në funksion të agjendës politike të partisë politike. Në rastin e Tiranës, kemi të bëjmë me konsultime e dëgjesa në kuadër të planit të aktiviteteve të Partisë Socialiste dhe jo me konsultime në funksion të detyrimit ligjor dhe përcaktimit të legjisllacionit në fuqi për bashkitë dhe njësitë administrative.

Konkretisht, në secilën nga dëgjesat ka pasur të njëjtin dekor organizimi, - fjalim nga kryetarja e PS Tiranë zonja Blerina Gjylameti, fjalim nga deputetët ose ministrat e PS-së që mbulojnë brenda partisë njësinë përkatëse elektorale dhe më pas fjalim nga kryetari i bashkisë. Dy fjalimet e para janë 100% politike dhe në funksion të politikës së ditës, kryesisht me sulme politike ndaj rivalëve politikë dhe me vlerësime të larta për qeverinë qendrore, kryeministrin, Partinë Socialiste dhe drejtimin politik të bashkisë. Fjalimet e kryetarit të bashkisë në çdo rast kanë pasur dy pjesë: pjesa e parë sulme politike ndaj rivalëve politikë dhe në funksion të agjendës politike të ditës, dhe pjesa e dytë (më e zgjeruar sesa pjesa e parë) bërjen e një bilanci të aktivitetit të bashkisë në zonën përkatëse dhe projektet në vijim deri në zgjedhjet e vitit 2019.

Sipas të dhënave të ekipit monitorues të ISP trendi i organizimit dhe i fjalimeve u ruajt në secilën prej dëgjesave publike të bashkisë Tiranë edhe gjatë muajit të fundit. Konkretisht,

- më 17 nëntor, njësia Vaqar, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 9 nëntor, njësia 9, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, ministra Ogerta Manastirliu dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 5 nëntor, njësia Kashar, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 3 nëntor, njësia 7, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 30 tetor, njësia 11, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, deputeti Ulsi Manja dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 29 tetor, njësia 10, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, ministri Fatmir Xhafaj dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 28 tetor, njësia 1, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, deputetja Elona Gjebrea, dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 26 tetor, njësia 2, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, deputetja Vasilika Hysi dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 25 tetor, njësia 6, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 23 tetor, njësia 3, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, deputeten Klotilda Ferhati dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 22 tetor, njësia 5, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, ministri Pandeli Majko dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 17 tetor, njësia 4, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, deputetin Sadri Abazi dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.
- më 15 tetor, njësia 8, agjenda e takimit kishte fjalim me folës kryesore kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti, deputetin Ervin Bushati dhe kryetari i bashkisë Erjon Veliaj.

Pretendimi se deputetët e ftuar janë të zgjedhur të zonës nuk vlen në raste të tilla, për sa kohë sistemi ynë zgjedhor nuk lejon identifikimin e deputetëve me zona elektorale, por në nivel qarku dhe se emra të veçantë të deputetëve të mësipërm, zyrtarisht kanë bërë fushatë elektorale më 2017 në zona të tjera nga zonat ku janë caktuar aktualisht nga partia e tyre politike. Shoqërimi nga deputetët ka vlerë kur deputetët janë në mazhoritar dhe ata janë gjithashtu pjesë e hallkës llogaridhënëse. Fakti se në asnjë takim nuk ka pasur të ftuar dhe as prezentë deputetë të tjerë të parlamentit, kryesisht të partive të tjera, do të thotë se nuk kemi të bëjmë me aktivitet bashki – deputetë në funksion të konsultimit, por aktivitet në funksion të axhendës politike të partisë, së cilës i përket kryetari i bashkisë.

Një detaj tjetër interesant në rastin e Tiranës është ai se në mbledhjet e llogaridhënës apo konsultimit publik nuk ka pasur pjesëmarrje aktive të Këshillit Bashkiak dhe strukturës së qarkut si institucione më vete, por vetëm të atyre këshilltarëve që mbulojnë në linjë partie zonat përkatëse, - të dyja këto institucione, pjesë të rëndësishme të vendimmarrjes në nivel lokal dhe elementë të rëndësishëm të legjislacionit dhe praktikës për konsultimin publik.

---

## 4.2. BASHKITË KAMËZ: GAZETË LOKALE, POR MUNGESA NË KONSULTIMET PUBLIKE

---

Në dallim nga bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz ka gazetë bashkiake mujore, të cilat botohet rregullisht. Gazeta shpërndahet falas dhe ka informacione të shumta për aktivitetet e bashkisë dhe problematika të veçanta lokale. Megjithatë, një monitorim skematik i gazetës tregon se ajo më shumë i dedikohet mbështetjes personale dhe politike të kryetarit të bashkive dhe stafit drejtues sesa informimit real dhe shumëplanësh të qytetarëve mbi të gjitha problematikat e bashkisë.

Bashkia Kamëz ka gjithashtu një faqe interneti me informacion jo aktiv dhe mungon tërësisht këndi i informimit mbi praktikën e konsultimit publik dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Në kategorinë lajme nuk ka asnjë informacion, (<http://www.kamza.gov.al/> Lajme Te tjera” nuk ka asnjë informacion, në kategorinë “kalendari i aktiviteteve” lajmi i fundit lidhet me aktivitetet e bashkisë të zhvilluara më 2012, plot 6 vjet më parë në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë. Edhe në kategorinë “projekte” gjenden informacione vetëm për projektet e periudhës 2013-2014, pra të shumë viteve më parë. Bashkia Kamëz ka informacione të shumta ditore në faqet e saj në rrjetet sociale, kryesisht në facebook, (<https://www.facebook.com/bashkiakamez/>). Në rrjetet sociale jepen informacione mbi aktivitetet, ilustrime me foto dhe tekst, njoftime, etj, por kryesisht informacione që janë në interes të bashkisë për qytetarët, jo anasjelltas, në interes të qytetarëve ndaj bashkisë. Të njëjtat informacione me të njëjtën praktikë pasqyrimi jepen edhe në faqen zyrtare të bashkisë, në kategorinë “media galeri”.

Në faqen zyrtare të bashkisë Kamëz nuk ka asnjë të dhënë mbi praktikën e konsultimit publik gjatë 2018 dhe më parë. Vetë zyrtarët e bashkisë konfirmojnë se zhvillojnë praktika të tilla konsultimi, por ekipit të ISP nuk u arrit t’i vihej në dispozicion dëshmi zyrtare për praktika dhe aktivitete të tilla.

Lidhur me aktivitetin konsultativ nga ana e këshilltarëve nuk gjendet asnjë e dhënë në faqen zyrtare dhe as në burimet e tjera të informimit zyrtar mbi përfshirjen e këshillit dhe të këshilltarëve në praktikën e konsultimit dhe të llogaridhënies publike.

---

## 4.3. BASHKIA VORË: “JO PARTIAKE”, PROBLEMET NË BILANCIN E KONSULTIMEVE

---

Bashkia Vorë gjithashtu ka gazetë lokale, të botuar periodikisht dhe me cilësi thuajse të njëjta me praktikën e ndjekur nga bashkia Kamëz. Në dallim nga secila bashki (Tirana dhe Kamza) bashkia Vorë e ka shumë më pak të theksuar identifikimin partiak dhe është më e fokusuar në problematikat lokale dhe në aktivitetin si bashki. Gazeta shpërndahet falas dhe paraqet informacione të ndryshme për bashkinë dhe aktivitetin e saj, duke nxjerrë në pah sukseset e në punët e saj.

Bashkia Vorë ka gjithashtu faqe interneti aktive dhe në dallim nga bashkia Kamëz e Tiranë, ka njoftime të shumta që lidhen me praktikën e saj konsultative me grupe të ndryshme interesi lidhur me vendimmarrjet, sidomos për buxhetin. Një analizë e detajuar e njoftimeve të shoqëruara me foto dhe me tekst, rezultoi se disa prej njoftimeve prioritare i përkasin kryesisht vitit 2017 dhe konsultimeve lidhur me buxhetin e vitit 2018, sesa vitit 2018 dhe konsultimeve për vitin 2019. Po ashtu një pjesë e kategorive të njoftimeve në faqen zyrtare nuk kanë asnjë informacion të përditësuar. Ashtu si bashkia Tiranë dhe Kamëz edhe në bashkinë Vorë vëmendje prioritare i është

---

dhënë njoftimeve të rregullta të aktiviteteve të bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë në rrjetet sociale, sidomos në facebook.

Konkretisht, në faqen zyrtare të bashkisë në FB ([www.facebook.com/BashkiaVore/](http://www.facebook.com/BashkiaVore/)) janë publikuar të dhëna me test e foto edhe për praktikën e konsultimit publik. Kështu, bashkia Vorë ka zhvilluar konsultime publike me datë 23 nëntor 2018 ku sipas njoftimit “u prezantuan Paketa Fiskale dhe Projekt Buxheti 2019 ku të pranishëm ishin grupet e interesit, specialistë, anëtarë të këshillit bashkiak, institucionet e interesuara, OJF, Qytetarë të bashkisë Vorë”. Më 16 nëntor ka një njoftim tjetër prezantimi të punës dhe problematikave të dy sektorëve në bashki, - sektori i Informimit dhe marrëdhënieve me Publikun, në funksion me ofrimin e shërbimeve cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Bashkia Vorë i ofroi ISP fotokopje të informacioneve mbi aktivitetet në kuadër të konsultimit publik të zhvilluar gjatë vitit të kaluar dhe fillim-vitit aktual, përfshirë listë-prezenca dhe informacion të shkruar. Megjithatë ashtu si edhe bashkitë e tjera edhe në Vorë nuk ka të dhëna publike institucionale për aktivitetin e këshillit dhe të këshilltarëve në funksion të llogaridhënies dhe konsultimit me qytetarët.

#### **4.4. BASHKIA KAVAJË: AKTIVITETE, POR MUNGESA NË STANDARDET E KONSULTIMIT**

---

Bashkia Kavajë, në dallim nga bashkitë Vorë, Kamëz e Rrogozhinë ka një jetë kulturore më të pasur, për shkak të traditës dhe historisë së qytetit. Kavaja nuk ka media televizive efektive, por ka media online (p.sh, TV Drita), të cilat informojnë vazhdimisht qytetarët me akses në internet mbi aktivitetet dhe problematikat lokale. Bashkia Kavajë ka një numër të madh aktiviteteve kulturore e sportive, dhe në bilanc vjen bashkia e dytë më aktive në qarkun Tiranë, pas Bashkisë Tiranë. Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme që sollën rotacion në bashki, Kavaja futet ndër bashkitë ku pasqyrohet vetëm aktiviteti i kryetarit dhe i Këshillit, kryesisht në aspektin mbështetës të drejtimit politik të bashkisë.

Faqja zyrtare e bashkisë Kavajë ka informacione të shumta, por në krahasim me standardet dhe kërkesat që përcakton legjislacioni mbi konsultimin publik dhe transparencën, konstatohen mungesa serioze në informim dhe në publikime. Konkretisht, nuk ka asnjë lajm mbi aktivitete të ndryshme që lidhen me konsultimet publike me komunitetin dhe grupet e interesit lidhur me vendimmarrjen lokale, lidhur me buxhetin ose projektet e tjera të rëndësishme, siç nuk ka të dhëna për kalendar konsultimesh, takimesh apo tërheqje opinionin nga qytetarët dhe burimet e tjera alternative.

Në faqen zyrtare publikohen rregullisht njoftime nga aktivitetet e kryetarit dhe bashkisë, takime zyrtare dhe njoftime për ecurinë e punës së bashkisë në projekte të vogla lokale. Tek kategoria “aktivitete” njoftimi i fundit i përket takimit rreth ngritjes e funksionimit të mekanizmit të koordinimit dhe referimit dhunës në familje (për më shumë: [http://www.bashkiakavaje.gov.al/web/Aktivitete\\_233\\_1.php](http://www.bashkiakavaje.gov.al/web/Aktivitete_233_1.php)) kurse tek kategoria “njoftime” prezantohet projekti i parkut, por pa të dhëna shoqëruese mbi konsultimet publike mbi të ([http://www.bashkiakavaje.gov.al/web/Projekti\\_i\\_Parkut\\_491\\_1.php](http://www.bashkiakavaje.gov.al/web/Projekti_i_Parkut_491_1.php)), etj.

Në traditën e punës së bashkive të reja, edhe bashkia Kavajë ka një faqe aktive në rrjetet sociale, sidomos në facebook (shih <https://www.facebook.com/BashkiaKavaje/>) ku pasqyrohen në mënyrë më të detajuar dhe në forma të ndryshme (video, grafikë, foto, tekst, komente, etj) aktivitetet e vetë bashkisë dhe aktivitetet brenda territorit të bashkisë. Në faqe publikohen edhe rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit Bashkiak dhe vendimmarrjet kryesore (<https://www.facebook.com/BashkiaKavaje/photos/pcb.2212861175659953/2212861052326632/?type=3&theater>), si dhe ashtu si në rastin e Vorës ka raste të shumta kur bashkia (administratori i faqes online) ndërhyjnë me komente e informacione sqaruese për qytetarët që ngrenë problematika të ndryshme në komunitetin ku jetojnë. Edhe në këtë hapësirë komunikimi nuk ka të dhëna për konsultime publike, dëgjesa, kalendar apo forma të tjera të përcaktuara si standarde nga legjislati i mbi konsultimet dhe ai mbi qeverisjen vendore.

Në takimin me fokus grupe në Kavajë përfaqësues të komunitetit lokal ngritën problematikën se e kanë të vështirë të marrin info nga bashkia për mbledhjet e këshillit në funksion të së drejtës së tyre për pjesëmarrje në mbledhje në rastin e vendimeve që kanë interes prioritar me ta.

#### 4.5. BASHKIA RROGOZHINË: BILANC KRITIK I STANDARDEVE TË KONSULTIMIT

Bashkia Rrogozhinë është bashkia më e re në qarkun Tiranë dhe me sfida më të mëdha për të krijuar identitet në kuadër të reformës së re territoriale. Bashkia ka drejtim politik nga aleanca midis PS e PDIU, koalicion politik që ka ndryshuar pas zgjedhjeve 2017, dhe për pasojë, me reflektim edhe në ecurinë e prioriteteve në raportet midis qeverisë qendrore dhe bashkisë Rrogozhinë. Bashkia nuk ka media lokale (gazeta dhe TV), por përdor mjetet e tjera të mundshme në dispozicion për komunikim me qytetarët (faqja e internetit e bashkisë dhe rrjetet sociale).

Në faqen e internetit të bashkisë Rrogozhinë (<http://bashkiarrogozhine.gov.al>) gjenden të dhëna të përgjithshme mbi bashkinë, por ka edhe të dhëna specifike që jepen në mënyrë më të detajuar edhe se disa prej bashkitë e tjera të qarkut, p.sh, informimi më i detajuar i buxhetit 2017 dhe 2018 (shih <http://bashkiarrogozhine.gov.al/images/docs/Buxheti-2018.pdf>).

Referuar standardeve dhe kërkesave që kërkon legjislati i mbi konsultimet publike dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, nuk ka asnjë të dhënë na faqen zyrtare të bashkisë mbi aktivitete të programuara apo të zhvilluara, nuk ka kalendar dhe as projekt pune, si dhe nuk gjenden të dhëna të tilla as në mediet e tjera që lidhen direkt ose indirekt me bashkinë. Duke qenë një bashki e re dhe me kapacitete minore të aktorëve civilë aktiv në bashki, pa prezencë të medias dhe me sfida të mëdha në menaxhimin e një territori të ri të dyfishuar në kuadër të reformës së re administrative, informacioni që qarkullon në raportet bashki – qytetarë dhe anasjelltas, në rastin e Rrogozhinës, është ende larg standardeve të ligjit.

Në mediet sociale, kryesisht në facebook, ofrohen të dhëna të përgjithshme mbi planet e zhvillimit të bashkisë, projekte konkrete në zonat turistike, etj, si dhe jepen njoftime mbi punë e projekte që po vijnë, por nuk ka të dhëna dhe as tregues se ato janë produkt i një konsultimi publik. Nga ana tjetër, në dallim nga bashkitë e tjera, nuk ka as pretendime kritike për mospërmbushjen e standardeve dhe kërkesave të ligjit nga grupet e ndryshme politike e qytetare në bashki, një tregues ky i brishtësisë së përfaqësimit qytetar dhe institucional në këtë bashki.